



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.519, datë 21.12.2021

PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË SHOQËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME MEMALIAJ SH.A.

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 21.12.2021 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit "Për licencimin për herë të parë të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Memaliaj sh.a.",

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Memaliaj (**UK Memaliaj**) me shkresën nr. Prot. 130 prot., datë 22.10.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për licencim për herë të parë.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për herë të parë të UK Memaliaj në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "*Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*" (**VKM nr. 63**).
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Memaliaj sh.a (NUIS M09831502C) është themeluar me statut nga Bashkia Memaliaj më 23.12.2020 dhe është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datë 31.12.2020, me aksionarë të vetëm Bashkinë Memaliaj;
  - b) Shoqëria UK Memaliaj aplikon për licencim për herë të parë si shoqëri e re, për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, e shkëputur nga UK Tepelenë me të cilën ka qenë e bashkuar deri në momentin e ndarjes ;
  - c) Drejtues teknik i shoqërisë z. Lula Koçiu është diplomuar në Bachelor pranë Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në degën Inxhinieri Mekanike në vitin 2015;
  - d) Shoqëria UK Memaliaj ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 10 254 banorë të Bashkisë Memaliaj.
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Memaliaj, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
  - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës" të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Memaliaj është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Memaliaj sh.a me (NUIS M09831502C), në kategoritë:
  - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
  - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Memaliaj sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues Ligjor – Petrit Shaha
  - b) Drejtues Teknik – Lula Koçiu
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Memaliaj sh.a është Bashkia Memaliaj.
  4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.
  5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Memaliaj sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
  6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Memaliaj sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**